



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

## REAGIM PUBLIK

Përmes rrjeteve sociale u njoftuan lidhur me reagimin e Dr. Florim Cuculi për taksën administrative për akreditim të punëtorisë për EKG të organizuar nga Sono-Kos sh.p.k. i cili ka konsideruar të njejtë si akt buroktatik dhe të turpshëm.

Oda e Mjekëve të Kosovës së pari sqaron se taksat për akreditim të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional janë caktuar me aktet juridike të aprovuara nga Kuvendi i OMK-së si organ me kompetencë ligjore për të përcaktuar lartësinë e taksave dhe tarifave përkatëse që caktohen për procedurat administrative që zhvillohen në zbatim të kompetencave publike. Së dyti, theksojmë se kategorizimi i taksave për akreditim është bërë duke marrë për bazë disa faktorë, ndër të cilët është edhe subjekti që parashtron kërkesën për akreditim. Në këtë kuptim, të gjitha subjektet e regjistruara në cilësi të bizneseve fitimprurëse, në këtë rast Sono-Kos, pa marrë parasyshë kuotizimin (pagesën) e pjesëmarrësve në aktivitet, duhet të paguajnë taksën administrative për akreditim në vlerë prej 700€. Ndërsa, subjektet e themeluara për realizimin e përfitimit publik të regjistruara në cilësi të OJQ-ve e të cilat nuk kanë kuotizim (pagesë) për pjesëmarrës, nuk paguajnë taksë administrative për akreditim. Andaj, duke konsideruar se për punëtorinë e EKG-së me ligjëruar Dr. Cuculi është aplikuar përmes subjektit biznesor me status fitimprurës, taksa administrative për akreditim është caktuar në shumën prej 700€.

Stigmatizimet nga individët që kanë mediatizuar pabazë dhe pa siguruar informata relevante mbi arsyeshmërinë e vëniies së taksës së tillë për akreditim të eventit, janë qëllimkëqija dhe ofenduese për organizatën tonë e cila kompetencat e saj i ushtron sipas urdhrit ligjor. Të hyrat nga taksat janë burime vetanake të garantuara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, përfshirë këtu edhe taksat e akreditimit të eventeve të organizuara nga kompanitë farmaceutike alokohen në vijën bugjetore të edukimit të vazhduar profesional të OMK-së, të cilat shfrytëzohen për përkrahjen dhe organizimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional, nga të cilat përfitojnë mjekët anëtarë të OMK-së.

Vjelja e taksave dhe tarifave të tillë janë të bazuara edhe në Direktivën e BE-së për sponzorizime nga ana e kompanive farmaceutike dhe të pajisjeve medecinale, Direktivë e zbatueshme nga janari i vitit 2018. Besojmë që secili person i interesuar mund të konsultoj këtë akt juridik të zbatueshmë në të gjitha vendet e BE-së si dhe referent në harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së nga shtetet që aspirojnë anëtarësimin në te.

Poashtu, para se të fajsohet OMK-ja, do të duhej të bëhet një krahasim i praktikës së odave dhe asocacionet të tjera simotra në vendet tjera evropiane. Përfundimet nga krahasimi i praktikës së tillë do të rezultojë me atë se OMK-ja është e vëtmja organizatë e mjekëve e cila vazhdon sponzorizimet e eventeve të EVP-së në dobi të mjekëve dhe shoqatave profesionale mjekësore!

Oda e Mjekëve të Kosovës, me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e edukimit të vazhdueshmë profesional, vetëm gjatë vitit 2019 OMK, ka ndarë shumën prej afér 100.000,00 € të dedikuara për edukim të vazhdueshmë profesional, prej të cilave 3/4 nga fondet e veta dhe 1/4 nga sponzor dhe donator. Në këto evenete të organizuara nga Oda dhe shoqatat profesionale mjeksore, pa asnjë kuotizim, kanë marr pjesë mbi 6.000 mjek dhe student të vitit të 5 dhe të 6 të Fakultetit të Mjeksisë të UP. Po nga këto të hyra, është botuar për herë të parë në trojet shqiptare, enciklopedia e mjekëve shqiptar.

Prandaj, në mungesë të informatave, nuk është e dinjitetshme, sidomos nga individë që janë pjesë e komunitetit mjekësor, e që disa nga ta që kanë udhëhequr me institucionet shëndetësore në Kosovë, ta quajnë organizatën tonë si "biznismen". Aktet e tillë janë të ulëta dhe të turpshme që nuk i përkasin dinjitetit profesional të mjekut.

Në fund theksojmë se Oda e Mjekëve të Kosovës mirëpret organizimet e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshmë profesional dhe është e hapur për ofrimin e ndihmës financiare dhe cilësdo përkrahje për organizimin e aktiviteteve të tillë, gjithmonë brenda kornizave ligjore.

Me respekt,  
Dr. Pleurat Sejdiu

